



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3363/6 prot.

Datë 17.12.2025

V E N D I M

Nr. 1872/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.12.2025 u shqyrtua ankesa me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga “EMKO” SHPK, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr.REF-61731-09-17-2025, me objekt: “*Blerje pajisje mobilje për shkollën 9 vjeçare dhe kopështim “Dom Nikoll Kaçorri”*”, me fond limit 4.830.437 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Kamëz, me adresë: Bulevardi “Nënë Tereza”, Nr. 492, Kamëz, Tiranë

Ankimues: Operatori ekonomik “EMKO” SHPK, përkatësisht me NUIS K61424016V, me adresë: Fshati Lalm, Pasuria Nr.102/26, Zona Kadastrale 2376, Tirane.

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “SHAGA” SHPK, përkatësisht me NUIS J96822229J, me adresë: Rruga Hamdi Pepa, ish Parku i Industrise, Tirane.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:**I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 18.09.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr.REF-61731-09-17-2025, me objekt: “Blerje pajisje mobilje për shkollën 9 vjeçare dhe kopështim “Dom Nikoll Kaçorri””, me fond limit 4.830.437 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

II.2. Në datën 14.11.2025 autoriteti kontraktor ka përfunduar fazën e vlerësimit të ofertave. Ofertuesit janë njoftuar elektronikisht si vijon:

1. “Eduart Xhixha” PF	4,157,500 lekë, skualifikuar
2. “E M K O” SHPK	4,314,000 lekë, skualifikuar
3. “SHAGA” SHPK	4,700,000 lekë, kualifikuar
4. “ERALD” SHPK	4,749,800 lekë, skualifikuar
5. “Bajro Bros” SHPK	0 lekë, skualifikuar
6. “MUCA” SHPK	0 lekë, skualifikuar

Operatori ekonomik “EMKO” SHPK, është njoftuar elektronikisht nga KVO-ja për arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

“Ju nuk dorëzuat fizikisht dokumentacionin e paraqitur ne SPE, brenda afatit të percaktuar sipas VKM-së nr.285, datë 19.05.2021”Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar me VKM-në nr.710, datë 24.11.2021 neni 26/6 përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë fizikisht dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të nenit 26/2 të VKM-së të sipërcituar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.”

II.3. Në datën 17.11.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit në SPE.

II.4. Në datën 20.11.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/6107, protokolluar me nr. 3363/2025 protokoli, datë 21.11.2025, e operatorit ekonomik “EMKO” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr.REF-61731-09-17-2025, me objekt: “Blerje pajisje mobilje për shkollën 9 vjeçare dhe kopështim “Dom Nikoll Kaçorri””, me fond limit 4.830.437 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “EMKO” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Konkretisht pretendohet si vijon:

“1. Autoriteti kontraktor Bashkia Kames, zhvilloi procedurën e prokurimit publik me objekt: Blerje pajisje mobilje për shkollën 9 vjeçare dhe kopështin “Dom Nikoll Kaçorri me fond limit 4,830,437(kater milion e teteqind e tridhjetë mijë e katerqind e tridhjetë e shtate)leke pa tvsh, me nr.REF-61731-09-17-2025, zhvilluar ne daten 29.09.2025.

2.Në daten 29.10.2025, autoriteti kontraktor permes menuse se mesazheve te derguara nga autoriteti kontraktor, ka ftuar operatorin ekonomik EMKO shpk qe te dorezoje dokumentacionin e paraqitur ne tender dhe ate te vetdeklaruar, origjinal ose kopje te noterizuara te tyre, sipas parashikimit te nenit 26 pika 6 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “RrPP”, te ndryshuar.

3. Ne datën 13.11.2025, autoriteti kontraktor ka perfunduar me njoftimin perfundimtar te ofertave ne SPE dhe ka marre vendim per skualifikimin e ofertes se shoqerise tone me argumentin se: “Pas kerkese se bere nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Kamez, operatori ekonomik ofertues nuk eshte paraqitur prane autoritetit kontraktor per te dorezuar fizikisht dokumentacionin e ngarkuar ne Sistemin e Prokurimit Elektronik”.

4. Ne datën 14.11.2025, eshte publikuar Njoftimi i Fituesit pas te cilit fillojne afatet e ankimit. Arsyet ligjore pse ne nuk i jemi pergjigjur kerkeses se AK per dorezimin e dokumentave pas kerkeses se bere ne datën 29.10.2025, vjen per arsye se veprimi i AK per te kerkuar dorezimin e dokumentacionit original ose kopje te noterizuar, eshte ne kundërshtim me parashikimin e nenit 26, pika 6 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “RRPP”, te ndryshuar, citoj:

6. Ne procedurat e prokurimit me nje faze, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar, i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “I” dhe “j” te pikes 2 te ketij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike.

Sipas kesaj dispozite, percaktohet se dokumentat i kerkohen vetem operatorit ekonomik i cili eshte kualifikuar i pari. Ne rastin tone, kerkesa e autoritetit kontraktor per te dorezuar dokumentat eshte bere ne datën 29.10.2025, ndërsa njoftimi per klasifikimin perfundimtar te ofertave eshte bere ne datën 14.11.2025 !!

Referuar te gjitha argumentave dhe fakteve, provohet katerciperisht se veprimet e AK jane kryer plotesisht ne kundërshtim me nenin 26 pika te VKM nr. 285, date 19.05.2021 dhe per pasoje edhe skualifikimi i ofertes tone eshte kryer plotesisht ne kundërshtim me proceduren ligjore per kete rast.

Ne perfundim kerkojme:

-Pranimin e ankimit.

-Rivleresimin e procedures se prokurimit dhe pas rivleresimit autoriteti kontraktor permes SPE ti kerkoje operatorit tone dorezimin e dokumentave, duke caktuar si afat per dorezimin e tyre afatet e nenit 97 te LPP.

-Anulimin e njoftimit te fituesit paraprak dhe kthimin e operateve ekonomike ne statusin per tu vleresuar..”

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 3363/1 Prot., datë 25.11.2025.

II.6. Në datën 04.12.2025 është protokolluar në KPP me nr. 3363/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 10477/1 prot., datë 27.11.2025 me objekt: “Shkresë përcjellëse”. Bashkëngjitur kësaj shkrese autoriteti kontraktor ka sjellë në KPP vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të

Ankesave me nr. 10477 prot., datë 27.11.2025 sipas të cilës rezulton se ankesa e ankimesit është refuzuar nga KSHA, duke argumentuar si vijon:

“Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi u njoh me ankesën e operatorit ekonomik “EMKO” SHPK, konstatoi se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “EMKO” SHPK.

Konkretisht, në ankesë ngrihen pretendime se operatori ekonomik ofertues nuk i është përgjigjur kërkesës për të dorëzuar dokumentat pranë autoritetit kontraktor, pasi operatori merr informacion paraprakisht për njoftimin e vlerësimit përfundimtar të ofertave e më pas, i përgjigjet kërkesës së AK për të paraqitur dokumentat original ose kopje të noterizuar.

Operatori ekonomik “EMKO” SHPK pretendon se kjo arsye skualifikimi është në kundërshtim me parashikimin e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, ku përcaktohet konkretisht se: “Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike”. Në rastin tonë, kërkesa e autoritetit kontraktor për të dorëzuar dokumentat është bërë në datën 29.10.2025, ndërsa njoftimi për klasifikimin përfundimtar të ofertave është bërë në datën 14.11.2025.

Referuar pretendimeve të sipërcituara të operatorit ekonomik ankimes, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se në datën 29.10.2025, autoriteti kontraktor përmes menisë së mesazheve të dërguara ka ftuar operatorin ekonomik “EMKO” SHPK që të dorëzojë dokumentacionin e paraqitur në tender dhe atë të vetëdeklaruar, origjinal ose kopje të noterizuara të tyre, sipas parashikimit të nenit 26 pika, 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar.

Kjo kërkesë është pjesë e praktikës së zakonshme të verifikimit të dokumenteve dhe shërben për të garantuar se dokumentacioni i ofertës i depozituar elektronikisht është i saktë, autentik dhe i plotë. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë në çdo moment të procesit sqarime, plotësime apo dokumente fizike, nëse kjo është e nevojshme për të siguruar që dokumentacioni i ofertës përputhet me kërkesat e dosjes së prokurimit dhe me kriteret e kualifikimit. Mosparaqitja e dokumenteve të kërkuara çënon drejtpërdrejt procesin e vlerësimit dhe e bën të pamundur verifikimin e ofertës së operatorit.

Në rastin konkret, operatori “EMKO” SHPK nuk ka justifikuar mosparaqitjen e dokumenteve dhe nuk ka kërkuar sqarime nga autoriteti kontraktor. Vendimi i njëanshëm për të mos u paraqitur për dorëzimin e dokumentacionit fizik përbën shkelje të detyrimeve të pjesëmarrjes në procedurë.

Në këto kushte, autoriteti kontraktor, në pamundësi të verifikojë dokumentacionin e ngarkuar elektronikisht, ka qenë i detyruar të konstatojë se operatori nuk ka përmbushur kërkesat e vlerësimit dhe për rrjedhojë ta skualifikojë ofertën e tij. Skualifikimi i bërë më datë 13.11.2025, me argumentin se operatori nuk është paraqitur për dorëzimin e dokumentacionit fizik, është i bazuar në fakte dhe në kuadrin ligjor. Vendimi është marrë në mënyrë të drejtë, të arsyetuar dhe në përputhje me praktikën e konsoliduar të prokurimit publik. Për rrjedhojë, pretendimi i

operatorit ekonomik nuk gjen mbështetje ligjore dhe nuk cënon vlefshmërinë e vendimit të autoritetit kontraktor.

Në momentin që operatori ekonomik “EMKO” SHPK nuk është paraqitur edhe pse është njoftuar që më datë 29.10.2025, Autoriteti Kontraktor, duke mos pasur një njoftim lidhur me arsyet e vonesës apo mosparaqitjes së dokumentacionit me datën 13.11.2025, ka vijuar me njoftimin për paraqitje dokumentacioni operatorit ekonomik tjetër të renditur të parin.

Argumenti i operatorit ekonomik se dokumentet mund të kërkohen vetëm pas publikimit përfundimtar nuk qëndron, sepse bie ndesh drejtëpërdrejt me parimin themelor të konfidencialitetit dhe sekretit të procedurës së vlerësimit të ofertave. Sipas kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik, vlerësimi i ofertave është një proces i brendshëm, konfidencial dhe i mbyllur, deri në momentin kur autoriteti kontraktor ka përfunduar renditjen përfundimtare dhe publikon njoftimin përkatës në sistem. Pikërisht për këtë arsye, legjislatori ka përcaktuar në mënyrë të qartë se dokumentacioni fizik kërkohet vetëm nga operatori i renditur i pari.

Referuar sa më lart, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson se pretendimet e sipërcituara të operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.”

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga ana e autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues se: “Ju nuk dorëzuat fizikisht dokumentacionin e paraqitur në SPE, brenda afatit të përcaktuar sipas VKM-së nr.285, datë 19.05.2021” Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar me VKM-në nr.710, datë 24.11.2021 neni 26/6 përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë fizikisht dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të nenit 26/2 të VKM-së të sipërcituar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në datën 18.09.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr.REF-61731-09-17-2025, me objekt: “Blerje

pajisje mobilje për shkollën 9 vjeçare dhe kopështim “Dom Nikoll Kaçorri””, me fond limit 4.830.437 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

III.1.2. Referuar informacionit të autoriteti kontraktor me nr. 10477/1 prot., datë 27.11.2025, protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 3363/3 prot., datë 04.12.2025 dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe ankesës së operatorit ekonomik ankimues rezulton, se në datën 29.10.2025 autoriteti kontraktor i është drejtuar operatorit ekonomik ankimues “EMKO” SHPK, nëpërmjet SPE-së, me kërkesën si vijon:

“Ju jeni renditur i pari në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje pajisje mobilje për shkollën 9 vjeçare dhe kopështin “Dom Nikoll Kaçorri” me Numri i Referencës: RE-61731-09-17-2025, Fondi limit: 4.830.437,00 lekë, prandaj duhet të paraqiteni pranë Bashkisë Kamëz, brenda 3 (tre) ditëve për të dorëzuar fizikisht dokumentacionin e paraqitur në SPE në zbatim të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, [...], neni 26/6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë fizikisht pranë Bashkisë Kamëz dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të nenit 26/2 të VKM-së të sipërcituar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike”.

III.1.3. Më datë 13.11.2025, operatori ekonomik ankimues “EMKO” SHPK, i ka kthyer përgjigje autoritetit kontraktor, nëpërmjet SPE- së, shprehimisht si më poshtë vijon:

“Me anë të këtij njoftimi ju bëjmë me dije se sot kemi marrë njoftimin zyrtar për shpalljen si fitues në procedurën e tenderit të shkollës “Dom Kaçorri”. Në vijim të kërkesave të paraqitura nga autoriteti kontraktues, ju informojmë se brenda 24 ore do të paraqesim të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me afatet dhe rregullat e përcaktuara.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin dhe mbetemi në dispozicion për çdo sqarim të mëtejshëm.”

III.1.4. Në datën 14.11.202, ora 10:42, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Eduart Xhixha” PF	4,157,500 lekë, skualifikuar
2. “E M K O” SHPK	4,314,000 lekë, skualifikuar
3. “SHAGA” SHPK	4,700,000 lekë, kualifikuar
4. “ERALD” SHPK	4,749,800 lekë, skualifikuar
5. “Bajro Bros” SHPK	0 lekë, skualifikuar
6. “MUCA” SHPK	0 lekë, skualifikuar

Njëkohësisht operatori ekonomik “EMKO” SHPK, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, me argumentet si më poshtë vijon:

“Ju nuk dorëzuat fizikisht dokumentacionin e paraqitur ne SPE, brenda afatit te percaktuar sipas VKM-së nr.285, datë 19.05.2021”Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar me VKM-në nr.710, datë 24.11.2021 neni 26/6 përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë fizikisht dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të nenit 26/2 të VKM-së të sipërcituar , si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.”.

III.1.5. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.1.6. Në udhëzimin nr. 01, datë 03.06.2025 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike”, parashikohet shprehimisht se:

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit nga të gjithë anëtarët e KVO për të gjitha ofertat e dorëzuara nga operatorët ekonomikë, anëtari i autorizuar i njësisë së prokurimit duhet të bëjë në sistem mbylljen e fazës së vlerësimit të ofertave në sistem. Në këtë moment sistemi iu dërgon në mënyrë elektronike automatikisht njoftimin mbi klasifikimin e gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës. [...].

[...] Kujdes: Në përfundim të procesit të vlerësimit të ofertave, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe fillimit të afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon operatorit ekonomik të kualifikuar i pari të paraqesë nëpërmjet SPE dokumentacionin për të provuar deklaratimet e dhëna, sikurse parashikohet në nenin 26/6 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës së tij në rrugë elektronike, të cilat duhet të paraqiten në origjinal ose kopje të njehsuara me origjinalin”.

III.1.7. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohej për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të qarrantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.1.8. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

- a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohej për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohej të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe

dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

III.1.9. Në interpretim të sa më sipër KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka detyrimin t'i kërkojë, ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin. Në rastin konkret KPP vëren se momenti procedural i kërimit të dokumenteve origjinale dhe verifikimi i tyre nga ana e autoritetit kontraktor për operatorin ekonomik "EMKO" SHPK, duhet të ishte data 14.11.2025, datë në të cilën, referuar dhe sistemit prokurimeve elektronike rezulton të jetë përmbyllur dhe procesi i vlerësimit të ofertave nga ana komisionit të vlerësimit të ofertave, pasi dhe në udhëzimin nr. 01, datë 03.06.2025 "Për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike", parashikohet se: *Pas përfundimit të procesit të vlerësimit nga të gjithë anëtarët e KVO për të gjitha ofertat e dorëzuara nga operatorët ekonomikë, anëtari i autorizuar i njësisë së prokurimit duhet të bëjë në sistem mbylljen e fazës së vlerësimit të ofertave në sistem. Në këtë moment sistemi iu dërgon në mënyrë elektronike automatikisht njoftimin mbi klasifikimin e gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës. Pra nga sa më sipër rezulton se autoriteti kontraktor nuk ka ndjekur hapat proceduralë të parashikuar dhe në udhëzimin e sipërcituar, ku thuhet se pas përfundimit të procesit të vlerësimit nga të gjithë anëtarët e KVO për të gjitha ofertat e dorëzuara nga operatorët ekonomikë, sistemi iu dërgon në mënyrë elektronike automatikisht njoftimin mbi klasifikimin e gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, dhe pas këtij veprimi procedural autoriteti duhej të kryente veprimet procedurale që parashikon neni 26 pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku thuhet se **[...] Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni [...].** Referuar bazës ligjore të sipërcituar KPP gjykon se ligjvënësi ka përcaktuar një procedurë të caktuar për tu ndjekur nga ana e autoriteteve kontraktore, ndaj veprimi procedural i datës 29.10.2025, i kryer nga autoriteti kontraktor, i cili, nëpërmjet SPE-së, i është drejtuar operatorit ekonomik ankimues "EMKO" SHPK, duke i kërkuar "dorëzimin e dokumentacionit provues në zbatim të nenit 26 pika 6 të VKM 285, datë 19.02.2021", KPP e gjykon të gabuar si zbatimin ashtu dhe interpretimin e ligjit në rastin konkret nga ana e autoritetit kontraktor, pasi në respektim të dispozitave të mësipërcituara autoriteti duhej si fillim të përfundonte vlerësimin e ofertave duke u dërguar klasifikimin përfundimtar operatorëve ekonomikë pjesëmarrës dhe më pas duhej ti **kërkonte ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni 26 të VKM 285, datë 19.02.2021**". Sikundër rezulton, nga faktet e parashtruara më sipër, autoriteti kontraktor nuk ka respektuar hapat proceduralë të parashikuar nga ligji në lidhje me kërkimin e dokumentacionit, ofertuesit të kualifikuar i pari për të kryer verifikimin e*

kapaciteteve të cilat ishin përmbushur deri në atë moment me anë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Gjithashtu KPP gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar afate strikte kohore për zhvillimin e procedurave të prokurimit në përgjithësi dhe në veçanti në lidhje me institutin e ankimit administrativ, të rishikimit të vendimmarrjes së autoritetit kontraktor. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka gabuar në zbatimin dhe interpretimin e ligjit në rastin konkret, pasi nuk ka marrë parasysh nenin 26 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, ku parashikohet shprehimisht se **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.** Vendimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave i datës 14.11.2025 mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “EMKO” SHPK si dhe vendimi për vijimin e hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit në lidhje me publikimin e aktit administrativ të njoftimit fituesit të procedurës më datë 17.11.2025, janë akte administrativ në kuptim të nenit 3 pika 1 të K.Pr.A, (ligji 44/2015) “si cdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete”.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se akti administrativ i KVO-së i datës 14.11.2025 në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues “EMKO” SHPK dhe akti administrativ për vijimin e hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit, pra publikimit të njoftimit të fituesit, do të konsiderohen si akte absolutisht të pavlefshme pasi kërkimi i dokumentacionit nga ana e autoritetit kontraktor në datën 29.10.2025 para përfundimit të afatit të njoftimit të klasifikimit e bën atë absolutisht të pavlefshme si veprim procedural. Në nenin 108 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikon se “Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me: i) kompetencën e organit publik; ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit; b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale; c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal; ç) në çdo

rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj.” Gjithashtu, në nenin 111 të K.Pr.A parashikohet se “Organi publik ka detyrimin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nëse vjen në dijeni për rastet e parashikuara në nenin 108 të këtij Kodi”. Ndër karakteristikat thelbësore të veprimit juridik absolutisht të pavlefshëm përmendim: (i) veprimi juridik që është absolutisht i pavlefshëm nuk shkakton pasojat juridike që synojnë palët; (ii) ai nuk ka fuqinë juridike të një veprimi juridik të vlefshëm; (iv) veprimi juridik i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm me asnjë veprim të mëpasshëm, as edhe kur ekziston vullneti i palëve (me aprovim, miratim), as me kalimin e kohës së parashkrimit dhe as me zhdukjen më vonë të shkakut të pavlefshmërisë (quod ab initio vitiosum est tractu temporis convalescere non potest). Komisioni i Prokurimit Publik në interpretim sistematik (domethënien e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), gjykon se ndodhet para kushtit të konstatimit prima facia të një akti administrativ absolutisht të pavlefshëm dhe në cilësinë e organit administrativ më të lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, parashikuar nga neni 24/1 i ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, konstaton se akti administrativ i Komisionit Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues “EMKO” SHPK, dhe publikimi i njoftimit të fituesit i datës 17.11.2025 të procedurës së prokurimit objekt-ankimi nga autoriteti kontraktor, janë akt administrativ absolutisht i pavlefshëm në kuptim të nenit 108 të K.Pr.A.

Sa më sipër, referuar nenit 110 të KPrA në të cilën parashikohet se “Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë. Ai konsiderohet se nuk ekziston.” autoriteti kontraktor duhet të marrë masat e nevojshme për kthimin e situatës juridike në gjendjen fillestare për operatorin ekonomik ankimues “EMKO” SHPK dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të kryejë veprimet procedurale në përputhje me parashikimet në udhëzimin nr. 01, datë 03.06.2025 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike”, në të cilin parashikohet se: “Pas përfundimit të procesit të vlerësimit nga të gjithë anëtarët e KVO për të gjitha ofertat e dorëzuara nga operatorët ekonomikë. Në këtë moment sistemi iu dërgon në mënyrë elektronike automatikisht njoftimin mbi klasifikimin e gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës”, dhe me parashikimet e nenit 26 pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku thuhet se **[...] Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni [...].** Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se hapat proceduralë të ndjekur nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit objekt-prokurimi cenojnë në thelb jo vetëm garancitë procedurale të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, por njëherazi cenojnë edhe parimin e sigurisë juridike. Në jurisprudencën e saj *Inter Allia*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr. 12/2014 datë 17.03.2014 është shprehur se “Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin”. Sa më sipër, KPP gjykon, se në rastin konkret parimi i sigurisë juridike në kuptimin material të tij,

konsiderohet edhe moscenimi i të drejtave të fituara dhe i pritshmërive të ligjshme që garantojnë aktet në fuqi. Akoma më tej, në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese *Inter Allia* në vendimin 15/2010 ka theksuar se “parimi i shtetit të së drejtës i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës nënkupton veprimin e të gjithë institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për atë që sa i lejon Kushtetuta dhe ligji duke mos i tejkaluar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore”. K.P.P. konstaton, se vendimi i Komisionit Vlerësimit të Ofertave i datës 14.11.2025 dhe vendimi i datës 27.11.2025 i Komisionit Shqyrtimit të Ankesave mbi ankesën e operatorit ekonomik ankimues “EMKO” SHPK, si një akt administrativ individual, i shtrin efektet *inter parties* dhe në asnjë rast *erga omnes*. Ndaj KPP, gjykon se këto vendime janë në kundërshtim me hapat proceduralë që parashikon LPP, ndaj këto vendime duhet të anulohen si vendime të dala në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik.

Sa më sipër, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të kishte shpallur fillimisht klasifikimin e operatorëve ekonomikë dhe më pas t'i **kërkonte ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese** për të bërë të mundur verifikimin e dokumentacionit origjinal të ankimuesit me atë të deklaruar në formularin e vetdeklarimit. KPP i tërheq vëmendjen autoritetit kontraktor, për mosrespektim të dispozitave ligjore në fuqi, lidhur me momentin procedural të verifikimit të dokumentacionit origjinal në shkellje të afateve ligjore. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor për procedurat e prokurimit të cilat realizon, duhet të garantojë respektimin e parashikimeve ligjore në fuqi dhe parimeve të transparencës dhe efikasitetit parashikuar në nenin 2 të LPP-së. Në këtë kuptim, KPP e gjen skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues, të pabazuar në ligj dhe në kapërcim të afateve ligjore në fuqi.

Për sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “EMKO” SHPK qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “EMKO” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr.REF-61731-09-17-2025, me objekt: “Blerje pajisje mobilje për shkollën 9 vjeçare dhe kopështim “Dom Nikoll Kaçorri””, me fond limit 4.830.437 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
2. Të konstatoj absolutisht të pavlefshëm vendimin e Komisionit Vlerësimit të Ofertave të datës 14.11.2025 për skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues “EMKO” SHPK dhe vendimin e datës 17.11.2025 të njoftim të fituesit të procedurës, si vendime absolutisht të pavlefshme të marra në kundërshtim me hapat proceduralë që parashikon ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe të rikthejë procedurën në gjendjen fillestare vetëm për këtë operator ekonomik ankimues në mënyrë që të kryejë vlerësimin e tij në përputhje me parashikimet e udhëzimit nr. 01, datë 03.06.2025 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike”, dhe parashikimet e nenit 26 pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “EMKO” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Florent Zguro

